



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 08.**

Prishtinë, më 5.07.2011 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Petar Miletić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, zëvendëskryetare e parë të Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistratit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009 , me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-012, me raportin e Komisionit funksionale për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së , me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.
6. Të ndryshme

Myzejene Selmani - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Krzesuesja - konstatoi se rendi i ditës u miratua me plotësim me pikën: Shqyrtimi i raportit me amendamente të Projektligjit nr. 04/ L- 011 për Organizimin Sindikal në Kosovë

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar.

Kryesuesja – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 22.06.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009 , me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009 të propozuara nga Komisioni Funkcional. Kërkoj nga anëtarët të deklarojnë nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funkcional.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 04/230/L-009. ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-012, me raportin e Komisionit funksionale për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së , me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-012, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-012, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L- 002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L- 002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L- 011 për Organizimin Sindikal në Kosovë me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/ L- 011 për Organizimin Sindikal në Kosovë , të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/ L- 011 për Organizimin Sindikal në Kosovë, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme

Kryesuesja- njoftoi Komisionin lidhur me Përfundimin i cilin ka ardhur nga Kryesia e Kuvendit për planifikimin e komisioneve parlamentare, grupeve të deputetëve, të deputetëve për udhëtime zyrtare jashtë vendit të financuara nga organizatat që mbështesin Kuvendin dhe ato që bien në barrë të shpenzimeve të Kuvendit, të cilat duhet të koordinohen me nënkryetarët e Kuvendit. Z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti.

Kryesuesja – theksoi se në bazë të Planit të Veprimit për Integritet Evropian për vitin 2011, si pikë të veçantë do të jetë mbikëqyrja e ligjeve.

Pas konsultimeve, Komisioni vendosi se me qëllim të informimit lidhur me implementimin e Projektligjit nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, javën e ardhshme do të ftojë Ministrin e Vetëqeverisjes Lokale, për të raportuar Komisionin.

Në bazë të analizave dhe të dhënave, Komisioni do të përpilon një raport me rekomandim për Kuvend, në funksionalizimin për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Myzejene Selmani